



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.203/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.203/2019 e datës 03.10.2019 e paraqitur nga Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter Neës Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 03.10.2019, me të cilën pretendon se kandidati për deputet Besian Mustafa, nga radhët e subjektit politik LDK, në postimin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar një foto në të cilën përfshihet një fëmijë. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë foto ku shihet Besian Mustafa dhe Arben Gashi, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, ka shkelur rregulloren 13/2013 e plotësuar me rregulloren 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet, përkatësisht nën 5 paragrafi 3 pika b) dhe paragrafi 2 pika d).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një foto lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se ankesa e BIRN dhe IKS është e pa baze, për arsye se pretendimet e tyre për shkelje të rregullores 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimit për ngjarjet, gjegjesisht nën 5 paragrafi 3 pika d) nuk qëndron nga se në foton të cilën e ka shpërndarë kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, është e vërtetë se një fëmijë është në foto dhe ka ngritur dy gishta mirëpo ky simbol është edhe simbol i paqes, më tutje theksojnë se tendenca me u thirr në atë se ka shkelje nuk është e drejtë, dhe këtë me shumë e shohin si tendencë paragjyquese sesa si një ankesë pasi që fëmija është në shoqërimin e prindërve dhe për këtë kanë ofruar dëshmi fletëpëlqimin për dy prindërit e tij, gjë që është në përputhje me rregulloren 20/2019, gjegjesisht me nën 1 i reformuar i nën 5.2 pika h).

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se subjekti politik LDK, dhe kandidati i tyre për deputet Besian Mustafa lidhur me postimin e fotos në facebook, në të cilën shihet një fëmije, nuk dëshmon se bëhet fjale për foton e cila shërben për të bërë apel për të votuar, dhe se fëmija në fjalë nuk ka asnjë simbol të partisë në fjalë. Në rastin konkret ngritja e dy gishtrinjve nuk mund të merret si thirrje për të votuar, madje në këtë foto nuk ka asnjë simbol apo material propagandues, simboli i dy gishtrinjve perdoret nga shumë njerëz pa asnjë ngjyrim politik në gjithë botën, si dhe në vendin tonë, edhe jashtë fushatës zgjedhore, dhe nuk mund ta konsiderojmë se në rastin konkret përbën keqpordorim të fëmijve në fushatë zgjedhore. Ndërsa edhe nga vet fotoja si tërësi, e bashkangjitur në ankes, nuk shihet që subjekti politik LDK, ka dashur të bej apel për të votuar.

Pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të rregullës zgjedhore 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 par. 3 pika d), nga ana e subjektit politik LDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të rregullës zgjedhore 20/2019, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullës zgjedhore nr.13/2013 me të cilën neni 5 paragrafi 2 pika h) thuhet ; *Personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, përveç kur janë të shoqëruar nga prindërit e tyre apo me pëlqimin e prindërve, gjë e cila është dëshmuar nga kandidati në fjale.*

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.203/2019 më datën 05.10.2019



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*